



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BRENDSHME**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**  
**AKADEMIA E SIGURISE**

Nr. 2106. Prot.

Tiranë, më 30. 7 2024

**THIRRJE PËR PJESËMARRJE**  
**NË KONFERENCËN X SHKENCORE**  
**“POLICIA E SHTETIT NË 80-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË ATDHEUT,**  
**ARRITJE DHE SFIDA”,**  
**TË AKADEMISË SË SIGURISË, TIRANË, 22 NËNTOR 2024**

Akademia e Sigurisë do të zhvillojë më datën 22 nëntor 2024 konferencën X shkencore “Policia e Shtetit në 80-vjetorin e Çlirimit të atdheut, arritje dhe sfida”. Pjesëmarrja në këtë konferencë është e hapur dhe AS-ja bën thirrje për stafin akademik, studentë të Akademisë së Sigurisë, ekspertë e studiues nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik e privat në vend, studiues e ekspertë të çështjeve të hetimit dhe të sigurisë në vend dhe vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare partnere të Policisë së Shtetit etj., që të bëhen pjesë e kësaj konference me punimet e tyre shkencore.

**DATA TË RËNDËSISHME**

Data e sjelljes së abstrakteve: abstraktet duhet të paraqiten deri më datë 2 shtator 2024. Data e sjelljes së punimeve të plota: pas konfirmimit punimi sillet i plotë deri në datën 31 shtator 2024.

Adresa ku do dërgohen punimet: [kerkimishkencor.as@gmail.com](mailto:kerkimishkencor.as@gmail.com)

**FOKUSI I KONFERENCËS**

Në këtë konferencë do të trajtohen tema rreth historisë së polisise që nga krijimi i saj, natyrisht, parë nën disa këndvështrime si, historikisht, organizativisht, por edhe në thelbin e vet me synimin që parashtrimi i historisë, analiza e sinteza e saj të na shërbejë jo vetëm si respekt për memorien, por mbi të gjitha si eksperiencë e vyer për të ecur përpëra në krijimin e konsolidimin e një policie moderne e me standarde më të larta të kohës.

Në konferencë ne synojmë të hapim diskutime mbi dimensione të reja të polisimit si p.sh. polici i komunitetit si një qasje e zbatimit të ligjit e cila thekson partneritetin dhe zgjidhjen e problemeve përmes adresimit të shkaqeve themelore të krimtit, por edhe të

çështjeve të tjera të sigurisë publike. Do të trajtojmë punën e metodat për ndërtimin e besimit e thellimin e bashkëpunimit me komunitetin duke e konsideruar atë jo vetëm si objekt, por edhe si subjekt i ruajtjes së sigurisë. Natyrisht që synojmë të hedhim në tryezë metodat e praktikat më të mira bashkëkohore të bashkëpunimit që nga patrullimi në këmbë, forumet e takimet komunitare, programet edukative e informuese duke synuar gjithnjë profilaksinë përpara terapisë.

Konferenca do i japë zë tranzicionit të policisë drejt një policie inteligjente, kemi parasysh këtu që nga përdorimi i analizës së të dhënave dhe inteligencës artificiale deri tek përmirësimi i efektivitetit operacional.

Puna e policisë e veprimtaria e saj synon përdorimin e një sistemi më të mirë të menaxhimit të informacionit, sistem që do parandalonte përmes identifikimit të zonave të nxehta, përdorimin efektiv të burimeve njerëzore e teknike, si dhe krijimin e një sistemi vendimmarrje të shpejtë e efikas.

Nga aspekti strategjik, mbrojtja nga kërcënimet e reja të kufijve virtualë dhe rrjeteve e sistemeve nga mashtrimet kompjuterike, është çështje e rëndësishme e sigurisë kombëtare. Sipas “Strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike 2020-2025”, prirja aktuale tregon se incidentet e kësaj natyre do të vazhdojnë të rriten. Zhvillimet dhe rritja e përdorimit të teknologjisë është me lidhje të pandashme me sigurinë.

Ndërmarrja e projekteve, studimeve e kërkimeve në fushën e krimeve dhe luftës kibernetike përfshin aplikimet shkencore, punimet, trajtimet, studimet dhe analizat e thelluara lidhur me procedurat, metodat e teknikat hetimore brenda e jashtë vendit; vlerësimin e faktorit të rezikut dhe ndikimit në shoqëri; digjitalizimin e komunikimit dhe format e reja të mbrojtjes, si dhe me programet, kurrikulat e modulet ekzistuese për këtë formë krimi, në kuadër të ndërtimit të strategjive të nevojshme për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore e materiale, për përmirësimin e metodave hetimore dhe për bashkëpunime të fushave e nivele të ndryshme në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Kjo konferencë do shërbeje në kuadrin shkencor, për të ndihmuar institucionet, programet, agjencitë, ekspertët për të nxitur debate konstruktive akademike e për të dhënë sugjerime për masa e politika për modernizimin e sistemit të edukimit në fushën e sigurisë së qytetareve të jetës e pronës së tyre, për ngritjen e sjelljes e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në një stad të ri siç e kérkon koha. Natyrisht që mendojmë se gjerësisht do trajtohet bashkëpunimi ndërkombëtar, nxitja e tij në nivel rajonal e me gjerë si dhe dhënia e ekspertizave e praktikave që ofrojnë risi dhe rekomandimet përkatëse për politikat në vazhdim të Policisë së Shtetit e më gjerë.

## OBJEKTI I KONFERENCËS

Objekti kryesor i kësaj konference, është paraqitja ne mënyrë sintetike e historikut të Policisë së Shtetit i parë nën këndvështrimin e ruajtjes së vlerave më të mira të promovimit të tyre si në aspektin etiko-moral dhe profesional si dhe zhvillimet më të fundit në të gjitha dimensionet, historike, shkencore, teknologjike, të bashkëpunimit rajonal e më gjerë dhe veçanërisht cili është roli i saj i ri në marrëdhëniet me publikun e në funksion të tij.

Natyrisht që e gjithë kjo gamë e gjerë ngjarjesh, e procesesh dinamike do paraqitet me punime të mirëfillta shkencore për të nxitur debate dhe për të trajtuar në nivel të gjerë,

kombëtar, rëndësinë dhe nevojën e njohjes dhe zgjerimit të dijeve dhe aplikimit të tyre përballë sfidave të së sotmes e të së ardhmes. Konferenca do të ndihmojë në mënyrë profesionale e shkencore në hartimin e politikave, masave, veprimeve të policisë në tërësi e padyshim përmirësimin rrënjosor të kurrikulave të përgatitjes, edukimit e trajnimit të strukturave të sigurisë.

## QËLLIMI I KONFERENCËS

Përthithja e mendimit të kualifikuar akademik, shkëmbimi i ideve, shprehja e opinioneve dhe komunikimi i rezultateve kërkimore në fushën e rendit e sigurisë publike, si dhe projektimi i drejtimeve të zbatimit të tyre në praktikë. Ky qëllim do trajtohet:

- *në aspektin historik,*
- *në aspektin analistik strategjik, si dhe*
- *në aspektin akademik.*

## SYNIMI I KONFERENCËS

- Shpalosja e eksperiencës dhe vlerave më të mira të trashëgura në historikun e Policisë së Shtetit, paraqitja sa më dinjitoze e historisë së saj të shkëlqyer në dekada;
- vlerësimi i mijedosit aktual në fushën e sigurisë publike, luftën kundër krimit, sigurinë e jetës së qytetareve, si dhe projektimi i drejtimeve të modernizimit të aktivitetit të saj në praktikë;
- paraqitja e sintetizuar e bashkëpunimit ndërkombëtar e rajonal me agjencitë homologe e partnere si domosdoshmëri në rritjen e efikasitetit të punës së policisë në vite;
- rekomandimet në fushën e rendit dhe sigurisë, si për politikat e zhvillimit e modernizimit të saj në të ardhmen ashtu dhe në përmirësimin e çdo aspekti të jetës e veprimtarisë së çdo individi pjesëtar të forcave të rendit.

## TIPI KONFERENCËS

Konferenca shkencore dhe do të ketë një auditor me staf akademik të Akademisë së Sigurisë, studiues dhe ekspertë vendas e të huaj të çështjeve të sigurisë, drejtues dhe specialistë të strukturave të Policisë së Shtetit, agjencive të tjera ligjzbatuese, përfaqësues të misioneve të huaja policore që asistojnë Policinë e Shtetit, përfaqësues të institucioneve akademike partnere në vend dhe të akademive, kolegjeve, universiteteve policore partnere të huaja si dhe gjithe te interesuarit me kontributet e tyre etj.

## STRUKTURA E KONFERENCËS

Konferenca do të organizohet në dy sesione:

*Roli i Policisë së Shtetit në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike(1944-2024). Arritje dhe sfida. (Aspekte historike, strategjike, operacionale e teknike procedurale, roli i ri në mbrojtje të jetës e pasurisë se qytetareve).*

1. Evoluciuni historik i Policisë së Shtetit Shqiptar. Transformimi i saj nga lufta kundër krimtit të organizuar deri te policimi në komunitet :
2. Transformimi i Policisë së Shtetit gjatë tranzicionit demokratik (1990-2024)
3. Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional për Policinë e Shtetit (1944-2024)
4. Implementimi i koncepteve të policimit në komunitet në Shqipëri: Progres dhe sfidat;
5. Policimi i bazuar në inteligjencë, policim i sfidave bashkëkohore
6. Menaxhimi i kufijve dhe migracionit: Evoluciuni i roleve dhe përgjegjësive të Policisë Kufitarë
7. Lufta kundër krimtit të organizuar në Shqipëri: Strategji, rezultate dhe sfida të vazhdueshme
8. Policia e Shtetit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut: Progres dhe sfida të mbeturë
9. Integriteti policor dhe lufta kundër korruptionit brenda forcave të rendit
10. Evoluimi i përgjegjësisë dhe llogaridhënieve së Policisë së Shtetit ndaj publikut dhe institucioneve mbikëqyrëse
11. Avancimi i barazisë gjinore dhe diversitetit në Policinë e Shtetit Shqiptar
12. Përmirësimi i marrëdhënieve polici-komunitet: Strategji efektive dhe mësimë të nxjerra
13. Roli i Policisë së Shtetit në menaxhimin e krizave dhe emergjencave civile

## Sesioni II

*Vlerësimi i modernizimit të Policisë së Shtetit si në pikëpamje organizative, të modernizimit të saj, bashkëpunimit me jashtë dhe përdorimit intensiv të metodave moderne të policimit.*

1. Modernizimi i teknologjisë dhe metodave të policimit në Shqipëri: Një retrospektivë 80-vjeçare;
2. evoluciuni i programeve të arsimit dhe trajnimit policor në Shqipëri;
3. zhvillimi i kapaciteteve forenzike të Policisë së Shtetit: historiku dhe perspektivat;
4. bashkëpunimi ndërkombëtar i Policisë së Shtetit: nga izolimi në integrim rajonal dhe evropian;
5. sfidat e sigurisë kibernetike dhe roli i Policisë së Shtetit në luftën kundër krimtit kibernetike;
6. roli i Policisë së Shtetit në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit;
7. sfidat e rekrutimit dhe mbajtjes së personelit cilësor në Policinë e Shtetit;
8. policimi i bazuar në inteligjencë: implementimi dhe efektiviteti në kontekstin shqiptar;
9. bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e sigurisë: roli koordinues i Policisë së Shtetit;
10. policimi në epokën digitale: adaptimi i Policisë së Shtetit ndaj ndryshimeve teknologjike;
11. vizioni për të ardhmen: sfidat dhe mundësítë për Policinë e Shtetit Shqiptar në dekadën e ardhshme.

## PJESËMARRJA NË KONFERENCË

Pjesëmarrja është e hapur: për staf akademik, studentë të Akademisë së Sigurisë, ekspertë e studiues nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të

ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik e privat në vend, studiues e ekspertë të çështjeve të hetimit dhe të sigurisë në vend dhe vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare partnere të Policisë së Shtetit etj.

### Akademia e Sigurisë

